ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit - Nr. i AP: **206-24-4993-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me Methadone nga LE**

A N K E S Ë

Identifikimi i ankuesit*

_____ **Argo Med SH.P.K.** _____
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ **Dëshmorët e Kombit P.N**, _____
(Adresa)

_____ **Viti** _____ *(Vendi)*

_____**61000**_____ *(Kodi postar)*

_____**044397044**_____ *(Numri Telefonit)*

_____ *(Numri i Faks-it)*

_____ **Agon Kajolli**_____
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **argomed1@hotmail.com** _____
(Adresa elektronike)

_____**04.07.2024**_____
(Data e parashtrimit të ankesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim me Methadone nga LE**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 22.05.2024.

Me datë 18.06.2024 kemi parashtruar kërkesë për sqarim të dosjes ë tenderit, ndërsa AK na ka kthyer përgjigje me datë 25.06.2024. Përgjigja e tyre ishte e thjeshtë duke mos e marrur fare për bazë kërkesën tonë andaj të pakënaqur me sqarimin e tillë, po i drejtohemi AK-së me kërkesë për Rishqyrtim.

AK me date 03.07.2024 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-se me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët**.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Hapja e tenderëve nuk është bërë akoma.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 22.05.2024. Me datë 18.06.2024 kemi parashtruar kërkesë për sqarim të dosjes ë tenderit, ndërsa AK na ka kthyer përgjigje me datë 25.06.2024. Përgjigja e tyre ishte e thjeshtë duke mos e marrur fare për bazë kërkesën tonë andaj të pakënaqur me sqarimin e tillë, po i drejtohemi AK-së me kërkesë për Rishqyrtim. AK me date 03.07.2024 e ka refuzua kërkesën tone andaj te pakënaqur me këtë vendim po i drejtohemi OSHP-se me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së Nr. 04/L-042,

AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së Nr. 04/L-042 dhe nenin 17 e 25 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së Nr. 04/L-042, dhe nenin të 19 i RRPP-001/2022,

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së.
Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjate hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të Specifikimeve Teknike, ka kufizuar konkurrencën duke aplikuar një kriter dhe kërkesë që i përjashton një numër të konsiderueshëm të prodhuesve të medikamentit në fjalë. Po ashtu ka vendosur kritere tjera diskriminuese dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK-së bie ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 28 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për furnizime sepse ka bërë favorizim të OE të caktuar që operojnë me vite të tëra në këtë lëmi. Krejt kjo konsiderohet favorizim i OE dhe njëkohësisht edhe diskriminim i të tjerëve e që bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së. Përpos kësaj ka lënë shumë elemente pa i përcaktuar saktë tek kërkesat për OE të cilat lënë vend për manipulim gjatë procesit vlerësimit të tenderuesve dhe rrezikojnë shumë të dëmtohet buxheti i AK-së.
Pikat dhe kriteret kufizuese do ti përshkruajmë tek pretendimet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së dhe RRPP-001/2022 që janë shkelur.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kërkesave teknike siç është specifikimi teknik, ka vendosur kriter/specifikim teknik kufizues e në të njëjtën kohë ka lënë disa kritere bazë që i përgjigjen ekskluzivisht natyrës së furnizimit pa i përcaktuar fare. Bazuar në këtë del që dosja e tenderit nuk është hartuar në përputhje me nenin 27 të LPP përkatësisht me nenin 1 të RRPP-001/2022. Ja si e përshkruan obligimin e AK-së në hartim të dokumenteve të tilla neni 17 i RRPP-001/2022.

Përpos kësaj Rregullorja kërkon nga AK që:

> 17.17 Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk:
> a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
> b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Ndërsa nenin 25 i po të njëjtës rregullore kërkon nga AK që:

25.6 Të gjitha kërkesat minimale për kualifikim do të jenë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale për objektin e kontratës në fjalë.

AK nuk e ka respektuar këtë andaj konstatojmë se gjatë hartimit të dosjes së tenderit janë shkelur parimet bazë të prokurimit, neni 27 i LPP-së si dhe neni 17 dhe 25 i RRPP-001/2022.

3: AK ka shkelur nenin 28 të LPP-së pasi LPP-së si dhe nenin 19 të RRPP-001/2022 pasi që në dosjen e tenderit tek Aneks 1 janë dhënë disa të dhëna për produktin të cilat konsiderojmë se janë kufizuese për disa OE.

Neni 28.2 i LPP-së dhe neni 19 i RRPP-001/2022 shumë qartë e tregojnë se si duhet të veproj AK kur fillon një procedurë të prokurimit për Furnizim. Ja si e përshkruan LPP këtë detyrim të AK-së:

Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Gjithashtu edhe neni 19.3 i RRPP-001/2022 e përshkruan këtë detyrim të AK-së për hartim e specifikimeve teknike të mirëfillta në kontratat e furnizimit. Ja si e thotë:

19.3 Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, përformanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimit. AK do të tregojë nëse specifikimet teknike të specifikuara janë obligative apo kërkesa minimale. Përdorimi i standardeve mund të përfshijë standarde të sigurimit të cilësisë siç është cekur në Nenin 70 të LPP-së.

Këto nene mendojmë se janë shkelur pikërisht me rastin e përcaktimit që **Forma farmaceutike** e **Methadone (10mg/ml)** sipas AK-së duhet të jetë **Tretësirë orale** duke e larguar mundësinë që kjo të jetë edhe në formën e tabletave. Pra kufizimi i tillë i përjashton nga konkurrenca e këtij aktiviteti të prokurimit një numër të caktuar të prodhuesve si dhe përfaqësuesit e tyre në Kosovë.
Bazuar në këtë sqarim si dhe bazuar në dokumentacionin e ofruar nga AK shihet se kërkesa jonë që të lihet mundësia e ofertimit edhe të medikamentit në formë të tabletave, është kërkesë e arsyeshme dhe mos aprovimi i kërkesës për sqarim konsiderohet i jashtëligjshëm. Pikërisht kjo është edhe arsyeja pse po e parashtrojmë këtë kërkesë për Rishqyrtim me të vetmin qëllim zgjerimin e mundësisë dhe konkurrencës që do ishte në të mirë të OE-ve dhe në të mirë të kursimit të Buxhetit të Shtetit.

Nisur nga gjendja faktike në dosjen e tenderit, si dhe nisur edhe nga krejt ato që thamë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e **OE "ARGO MED SH.P.K."** lidhur me tenderin "**Furnizim me Methadone nga LE**" i iniciuar nga **MINISTRIA E SHËNDETËSISË.**

ANULOHET njoftimi për kontratë i AK - **MINISTRIA E SHËNDETËSISË.**

DETYROHET: AK që të shtyjë afatin e tenderimit, të angazhohet seriozisht dhe të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit përkatësisht nga Aneksi 1, të vendos edhe kërkesa proporcionale me natyrën e furnizimeve e më pas të vazhdohet me procedurën në fjalë. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit, procedurës si dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk mund të marrim pjesë ne këtë procedurë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- 1 Njoftim per Kontrat
- 2 Template per Dosja e Tenderit 21.05.2024
- 3 Pershkrimi i Çmimeve
- 4 KERKES PER SQARIM TE DT
- 5 Sqarime shtese per OE
- 6 KERKESE PER RISHQYRTIM - MSH - ARGO MED SHPK - 03.07.2024
- 7 Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës për Rishqyrtim_ArgoMed

Vërejtje: **Të gjithë materialin në të cilin i kemi mbështetur pretendimet e gjeni të bashkangjitur ndërsa ofertën tonë e gjeni në materialin e procedurës së prokurimit që ndodhet në e-Prokurimit!**